D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|--|
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | |
| Nënshkrimi | |
| Vula | |
| Datë _____ | |

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

| 1 | 2 | 3 |
|-----|-----------------------|-----------------|
| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Norma e fitimit |
| 1 | | |
| 2 | | |

| | |
|---|--|
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | |
| Nënshkrimi | |
| Vula | |
| Datë _____ | |

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

| <i>1</i> | <i>2</i> | <i>3</i> | <i>4</i> | <i>6</i> | |
|---|------------------------------|--------------|------------------------|--|-------|
| Artikulli | Përshkrimi i mallit | Sasia | çmimi per njësi | Çmimi total për artikull (3 x 4X) | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| | Çmimi total (Mallrat) | | | | _____ |
| Çmimi Neto pa TVSH | | | | | |
| TVSH (%) | | | | | |
| Çmimi total me TVSH: | | | | | |
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | | | | | |
| Nënshkrimi | | | | | |
| Vula | | | | | |
| Datë _____ | | | | | |

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

Loti 1 “Blerje automjeti për inspektimin për AKSEM”

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

- **Automjeti për emergjencën duhet të ketë, këto specifikime teknike:**

a. Të përgjithshme:

- Automjeti: Me kilometra 0.
- Viti Prodhimit: 2022 – 2024.
- Lloji Automjeti: tip mikrobuzi.

b. Përmasat gabarite të automjetit:

- Gjatësia: Jo më pak 6700 mm.
- Gjerësia pa pasqyrat: Jo më pak se 2000 mm.
- Lartësia H Minimale 2600 mm.

c. Motorri i automjetit për emergjencën duhet të ketë, këto specifikime teknike:

- Lënda djegëse: NAFTË.
- Versioni motorrit: EURO VI.
- Cilindrata: Min 2800cc – Max 3500cc.
- Numri Cilindrave: 4 ose 6 (gjashtë).
- Fuqia: Jo më pak se Min 130 KË - 230 KË.
- Konsumi mesatarizuar i karburantit maksimale 12 l / 100km.
- Emërtimi CO₂ për ciklin e kombinuar maksimale 300 g /km.

d. Kabina duhet të ketë, këto specifikime teknike:

- Kabina të jetë e bashkuar me karrocerinë metalike
- Ngjyra: E kuqe.
- Numri dyerve: 5 (pesë).
- Numri vendeve: 8+1.
- Automjeti të jetë i kompletuar me sistemin zanor shtesë të alarmit si tek automjetet e policisë rrugore ose zjarrfikëseve, ambulancave vetëm për përmbushjen e shërbimeve urgjente të institucionit.
- Sistemi drejtimit: Elektro – mekanik, krahu i majtë.
- Kamio: Manuale/ Automatike.
- Sistemi Terheqjes: 4x4 (gomat të gjitha aktive).
- Distanca aksiale (aksin e dy gomave): Jo më pak se 3600mm.
- Kalueshmëria, Lartësia nga toka: Jo me pak se 192 mm.
- Pesha BOSH: Jo më pak se 1200 kg.
- Pesha me NGARKESË: Min 3500 kg
- Automjeti nga brenda, duhet te jetë i ndarë pjesa e ndenjësive nga bagazhi, dhe bagazhi duhet te jete i kompletuar me rafte për vendosjen e materialeve të avari –shpëtimit. Gjatësia e bagazhit pas ndenjësive: Min 1680 mm; Gjerësia e bagazhit pas ndenjësive: Min 1750 mm.
- Automjeti të jetë i pajisur nga pjesa përpara me arganello 6 ton – 7 ton.

e. Sistemi i frenimit duhet të ketë, këto specifikime:

- ESP: Programi Stabiliteti Elektronik.
- Asistenti aktiv i frenimit në rast emergjence.
- Asistenti i ruajtjes së trajektorës nga erërat anësore.

f. Opsione të ndryshme:

- Ndezja e mjetit me buton (Keyless).
- Mbyllja e dymve me komandë në distancë.
- Sistemi drejtimit i drejtpërdrejt, timoni multifunksional, krahu i djathtë
- Ajri i kondicionuar para dhe mbrapa.
- Radio me USB.
- I paisur me Airbag
- Sistem ndihmës për evitimin e përplasjes.
- Sistemi i ndriçimit sipas standartit të prodhimit nga fabrika
- Xhama të errësuar me veti termo – izoluese për pasagjerët.
- Filtri naftës me ndarës të ujit, gome rezervë, kuti e ndihmës së shpejt, trekëndësh.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Shtojca 5.

Loti 2 “Blerje 2 (dy) minibusa për transport personeli për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të përgjithshme:

Lloji i automjetit:

Sasia:

Kapaciteti:

Kilometra të përshkruara:

Viti i prodhimit:

Minibus për transport personeli

Minibus për transport personeli

2 (dy) copë

19+1 vende

0 km

2022-2024

Motori:

- Motori turbo diezel Min: 4 litra
- Lënda djegëse Naftë, Euro 6 min
- Fuqia motorike Min 150 kf
- Numri i cilindrave Min 4
- Konsumi i kombinuar për 100 km Max 12 litra/ 100 km

Transmisioni:

- Kutia e shpejtësisë (Kambio) Automatik ose Manual (5-marshe ose më shumë)

Aksesor shtesë:

- Me timon hidraulik dhe në krahun e majtë
- Frenat me sistem ABS, ASR
- Drita mjegulle
- Airbeg për shoferin dhe pasagjerin
- Xhamat me nuance
- Xhamat elektrik në dyert e para
- Ajër i kondicionuar Clima
- Sistemi elektrik 12V, si dhe të jetë konform normave të CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim në distancë .
- Radio me CD player.

A. Kërkesa të përgjithshme

1. Të ofrojë mjet rrugor të kërkuar në përshkrimet e Autoritetit Kontraktor.
2. Mjetet që do të përfitohen nga kjo kontratë të jenë të prodhuara në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, (kjo të vërtetohet me certifikate origjine)
3. Mjetet të jenë të pajisura me Certifikatë Konformiteti COC
4. Mjetet rrugore të kenë garanci jo më pak se 2 (dy) vjet. (Garancia të jetë e shënuar me normën në km që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë).

-
5. Afati i lëvrimin jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
 6. Ngjyra e negocueshme në momentin e lidhjes së kontratës.

B. Kërkesa të veçanta

1. Automjeti të dorëzohet i zhdoganuar, me detyrimet e shlyera në Organet Tatimore, i targuar dhe regjistruar në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
2. Në çmim janë përfshirë të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracioni dhe kolaudimi.
3. Shërbimet teknike të planifikuara herën e parë pas vënies së mjeteve në përdorim, të kryhen pa pagesë (kohë e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve të mirëmbajtjes).

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Shtojca 5.**Loti 3 “Blerje automjeti elektrik fuoristradë për Inspektoratin Qëndror”****FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

| Specifikimet teknike për blerje automjeti elektrik | |
|--|--------------------------------------|
| Viti I prodhimit | Minimum i vitit 2023 |
| Struktura e trupit | 5 dyer 5 ulese SUV |
| Gjatesia/Gjeresia/Lartesia(mm) | Minimum 4500*1800*1600mm |
| Pesha (kg) | Minimum 2000 |
| Baza e rrotave (mm) | 2765mm |
| Specifiket e Performances | |
| Lloji Karburantit | Elektrik I paster |
| Tipi I Motorrit | Sinkronizimi me magnet te perhershem |
| Fuqia e Motorrit | Minimum 150kE / 204PS |
| Maksimumi Maksimal I fuqise se rrotullimit | 310N·m |
| Tipi I Baterise | Bateri me Litium |
| Kapaciteti I Baterise | Minimum 60 kEh |
| Konsumi I Energjise | Minimum 7.5 kE/h / 100km |
| Autonomia e makines | Minimum 400km |
| Tipi I amortizimit para | Pezullimi I pavarur MacPherson |
| Tipi I amortizimit mbrapa | Pezullim I pavarur me shume lidhje |
| Sistemi I frenimit | |
| Tipi I frenave para | Disku I ventiluar |
| Tipi I frenave mbrapa | Frena daulle |
| Sistemi I frenave te parkimit | EPB |
| Specifikimi I gomave te para dhe mbrapa | Minimum 235/45 R19 |
| Karakterisitikat e sigurise | |
| Airbags perpara | PO |
| Airbags para anash rrjeshti I pare | PO |
| Airbags rrjeshti I dyte anash | PO |
| Sistem monitorimi I presionit te gomave | PO |
| Sinjal per rripin e palidhur | PO |
| Sinjal per rripin e palidhur per pasagjeret mbrapa | PO |
| Sistemi I frenimit kunder bllokimit (ABS) | PO |
| Frenim autonom urgjent | PO |
| Sistemi I mbylljes qendrore | PO |
| Hyrja pa celes | PO |
| Ndezje e makines pa celes | PO |
| Karakteristikat e ndihmes se shoferit | |
| Sistemi I imazhit te parkimit | PO |
| Mbajtja automatike | PO |

| | |
|---|------------------|
| Sistemi I asistences ne malore | PO |
| Funksioni I ndryshueshem I pezullimit | / |
| Konfigurimi I jashtem | |
| Dritare elektrike Para/Pas | PO |
| Fshirese me sensor sa fillon shiu | PO |
| Konfigurimi I Brendshem | |
| Paneli I instrumenteve LCD | Minimum 5.3-inch |
| Sediljet e para elektrike | PO |
| Mbajtes filxhani I sediljeve te pasme | PO |
| Konfigurimi Multimedial | |
| Ekrani LCD me prekje | Minimum 5.3-inch |
| Navigimi GPS | PO |
| Shpetimi Rrugor | PO |
| Bluetooth | PO |
| Internet Brenda ne makine | PO |
| Teknologjia e dritave | |
| Fenere LED | PO |
| Fenere Automatike | PO |
| Funksioni I voneses se fenereve | PO |
| Dritat e drejtimit LED gjate dites | PO |
| Rregullimi I lartesis se fenerit | PO |
| Feneri ne modalitetin e shiut/mjegulles | PO |
| Pasqyra e jashtme e pasme | |
| Rregullimi automatic | PO |
| Ngrohje elektrike | PO |
| Palosje elektrike | PO |
| Auto -palosje | PO |
| Air Conditioner | |
| Kontrolli automatic I klimes me dy zona | PO |
| Dalja e pasme e ajrit | PO |
| Garancia e automjetit | Minimumi 3 vjet |
| Garancia e baterise | Minimumi 8 vjet |

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Shtojca 5.

Loti 4 “Blerje Autoambulanca për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve”

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

I. STANDARTET E CILËSISË

| Kerkuar | nr. standarti | Ofruar |
|---|---|-------------------------------------|
| Autoambulancat dhe pajisjet plotësojnë standartin | SSH EN 1789:2007+A2:2014 ose ekuivalent | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Pajisjet per levizjen e pacienteve me ambulance | SSH EN 1865-1:2010+A1:2015 ose ekuivalent | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Automjeti i pajisur me | Çertifikate Konformiteti / CE ose ekuivalent | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Veshja e mureve të brendshme (<i>material vetrorezine/rezine</i>) të plotësojë standartin (<i>për qendrueshmerine ndaj zjarrit dhe flakes</i>) | SSH EN 13501-1:2018 ose ekuivalent | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Impianti elektrik plotëson standartet | CE (2014/35/EU) ose ekuivalent | <input checked="" type="checkbox"/> |
| të sigurisë së impianteve elektrike sipas normave europiane | CE (2014/30/EU) ose ekuivalent. | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Instalimi i impiantit 220V/240V të jetë konform normave të | SSH IEC 60364-7-708:2017 ose ekuivalent | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Pajisjet mjeksore të plotësojnë standartin | CE 93/42 ose ekuivalent. | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Të gjitha pajisjet e tjera plotësojnë standartin | CE dhe ekuivalent. | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Prodhuesit e automjeteve, ambulancës dhe pajisjeve plotësojnë standartet e cilësisë | ISO 9001:2015 ose ekuivalent. | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Furnizimi dhe montimi i pajisjeve dhe atrecaturës në Autoambulanca, sipas kërkesave të dhena nga AK, duhet të kryhet nga prodhuesi i autoambulancës ose | operator i autorizuar prej tij dhe i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Autoambulancat duhet të furnizohet të pajisura me të gjithë | dokumentacionin e kerkuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi | <input checked="" type="checkbox"/> |

II. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË AUTOMJETIT:

KATEGORIA E AUTOMJETIT Ambulance, Model A ,

| | |
|---|--|
| Viti i prodhimit të automjetit: | 2023-2024 |
| Modeli: | 2023-2024 |
| Tipi i motorit: | Motor Naftë (Diezel) |
| Statusi: | I ri me km zero ± lëvizjet e nevojshme për rregjistrim |
| Kapaciteti (cilindrata e motorit) në litra: | 2 deri 3 litra |
| Konsumi i kombinuar i karburantit: | Max: 10 litra /100km |
| Emetimi i gazrave: | Euro 6 – 6d |
| Sistemi i drejtimit: | Hidraulik |
| Numri i dyerve: | 4 (katër) |
| Kambio: | Manuale |
| Sistemi i drejtimit: | Me 4 rrota me një aks aktiv (4 x2) |
| Përmasat e ambulancës: | |
| Gjatësia (mm): | min 5900 - max 6120 |
| Lartësia (mm): | min 2600 - max 3000 |
| Lartësia e kabinës së pacientit(mm) : | min 1800 – max 2100 |

| | |
|--|--|
| Gjerësia pa pasqyra "B" (mm) | min. 2000 mm |
| Volumi i karrocërisë | min. 11 m ³ |
| Pesha mbajtëse | min. 1100 kg |
| Gjatësia e brëndëshme e kabinës së pacientit (mm): | 3250-3550 |
| Fuqia motorrike: | min 125 kf |
| Kapaciteti i serbratorit të naftës: | 50 - 75 litra |
| Transmisioni: | manual |
| Vendi i drejtuesit: | Në të majtë |
| Me kondicioner klimatik: | Në kabinën e drejtuesit dhe në pjesën e pasme të autoambulancës ku asistohet pacienti. |

Sisteme elektronike te sigurisë:

- ABS – sistemi kundër bllokues i rrotave gjatë frenimit,
- ASR – sistemi kundër rrëshqitjes këndore të rrotave,
- ESP – sistemi i stabilitetit elektronik,
- AIRBAG per shoferin dhe pasagjerin

Xhamat me hapje elektrike

Mbyllje të centralizuar të dyerve dhe komandim në distancë

Sirenë bitonale elektronike e inkorporuar me çift fenelinash / Fenelin një trup

Drita anësore dhe adezivet anësor, e kompletuar me modulator.

Antenë për frekuenca radio VHF/UHF.

Krik

Xhiro makine

Gomë rezervë

GARANCIA : 2 deri ne 3 vjet për automjetin.

II.1 Përshkrimi i jashtëm i autoambulancës:

Ngjyrat e autoambulancës: E bardhë

Aplikimi në autoambulancë i ngjyrave standarte sipas normativave europiane në fuqi.

Kryqi i esculapit, shenjë ndërkombetare e ndihmës së parë: Vendosija në të dy pjesët anësore, në të dyja dyert e pasme dhe në pjesën e sipërme të gabinës së autoambulancës, me dimensione të përshtatëshme dhe me ngjyrën ndërkombëtare.



Shirit perimetral

Aplikimi i një shiriti perimetrale fosforeshent autoadesive me ngjyrë portokalli me madhësi 20cm. Ky shirit vendoset edhe në pjesën e mbrendëshme të dy portave të pasme.



Shkrimi ambulancë

Aplikimi mbi kofanon e motorrit, të shkrimit AMBULANCA në të kundërt, me dimensione 6x60 me ngjyrë portokalli fosforeshente

Dizaini i makinës: Të shkruar "Ambulance" në fillim dhe në fund të trupit të mjetit.

III. PAJISJET E PËRGJITHSHME TË KABINËS SË PACIENTIT

GARANCIA : 2 vjet për autoambulancën (kabinën e pacientit).

Veshjet e brëndëshme

Veshjet e mureve të brendshme me material vetrorezine (fibra xhami), të jenë rezistente ndaj të gjitha substancave për pastrim dhe dezinfektim të cilat janë në bazë kimike ose biologjike – acid dhe rezistente ndaj flakës.

E gjithë hapësira e brendshme të jetë bërë në mënyrë që të gjitha nyjet të mbyllen dhe të veprojnë si një njësi e vetme kompakte. Dizajni i brendshëm të jetë i bardhë ose blu dhe të janë me termo izolim- dhe izolim akustik.



Izolimi - Mes llamarines së jashtme të automjetit dhe veshjes së brendshme prej vetrorezine të kabines së pacientit duhet të ketë mbështjelles termoizolues, dhe absorbues akustik, elastik, i pandezshëm, rezistent ndaj lageshtisë, mykut, antibakterial. Niveli i izolimit termik akustik të sigurojë një qëndrim të këndshëm dhe të reduktojë ndjeshëm humbjen e energjisë për ngrohjen ose ftohjen e hapësirës.



Panel ndarës me material vetrorezine ndërmjet kabines së shoferit dhe të pasagjerit.

Midis kabines së shoferit dhe kabines së pacientit të ketë një ndarje me material rezine ku të ketë dritare me xhama rreshqitës ose derë për komunikim.

Ne pjesën ballore të ketë ndarje ose xhepa për vendosje të materialeve mjekësore dhe sendeve mjekësore.



Mberthimi i pajisjeve-

Të gjitha pajisjet shtesë dhe pajisjet mjekësore të jenë të fiksuara drejtpërdrejt në trupin e

automjetit. Paisjet kryesore dhe struktura fiksohen në telajon e mjetit nëpërmjet sistemeve lidhëse.



Raftet- Raftet duhet te jene te derdhur, të përbërë nga vetrorezinë ose polyretan me bazë këndore të rumbullakosur dhe të qëndrueshem ndaj goditjeve, rezistent ndaj materialeve te pastrimit, desinfektimit dhe djegjes.

Pjeset e brendëshme ne hapsirën e emergjencës, kabinës së pacientit, të jenë pershtatura per te shfrytëzuar sa me mirë hapsirat.

Rafte të jenë mbi përforcimet e çelikut që përdoren për fiksime të sigurtë të njësive shtesë që janë të fiksuara mbi të, me mbyllje të siguruar.



Vende të posacme:

Në anën e majtë të pjesës së pasme të autoambulancës të jenë të montuar raftet dhe të ketë vende të posacme me material vetrorezine, të përshatur per hapsirat vendosjen e aksesorëve si më poshtë:

1. Set imobilizimi për frakturat e gjymtyrëve (splint tre masa)
2. Barela lëvizëse me dyshek.
3. Blllokues i kollonës cervikale (qafore)
4. Aspirator,
5. Respirator,
6. Barrele (traume spinale) per shtyllen kurrizore dhe blllokues koke
7. Sistem nxjerrje dhe imobilizimi spinal (KED, Kendrick Extrication Device)
8. Spider (Rrip sigurimi)
9. Gërshërë Robin
10. Pompe thithese portative (aspirator), volumi thithes min **1000 ml**, 12 V dhe 220 V
11. Monitor defibrilator per autoambulancat
12. Karroca Transportuese
13. Barelë Lugë
14. Karroca lëvizëse portative
15. Bombul zjarrfikëse (estintor) 2 kg
16. Çanta e emergjencës mjekësore për autoambulanca
17. Frigorifer autoambulance për medikamente

Tavani i autoambulancës:

Të jetë i veshur me material vetrorezine qe mund te pastrohet dhe desinfektohet lehtesisht. Të ketë ndricim maksimal në hapsirën e kabinës së pacientit.

Forma të lejojë futjen e një platforme me qark të dyfishtë për dritën, si gjatë ditës dhe gjatë natës, lehtësisht të inspektueshme, të aspiratorit për ajrim dhe qarkullim të ajrit, të ketë dy mbajtëse serumi të fiksuar në tavan, të ketë dorezë mbajtëse për personelin. Drita suplementare me ndriçim të përqëndruar.



Dyshemeja e autoambulancës:

Dyshemeja të jetë me material të përshtatshëm, të mbulohet me një lloj materiali biokomponent, që e bën sipërfaqen e saj jo të rrëshqitshme, antigërvishje, lehtësisht të dezinfektueshme dhe të thjeshtë për tu larë dhe pastruar.



Dera anësore:

Të jetë e rrëshqitshme, e veshur dhe me izolim, Të ketë dritare me xhama rrëshqitës.



Dera e pasme: Me dy dyer me hapje 180°, dyert e pasme të mjetit të jenë me xhama.

Dritaret:

Të jenë të mbuluara me xhama opake ose të veshur, me shiritë midis tyre që lejojnë shikim.

Bombul zjarrfikëse(estintor) 2 kg: 2 cope

Të ketë dy bombula(estintor) 2 kg një në kabinën e shoferit dhe një në pjesën e pasme të autoambulancës.

Instalimet Elektrike

Instalimi në kabinën e autoambulancës të një llambe me sistem fizarmonikë LED, që i mundëson shoferit shikimin e hartës rrugore gjatë natës pa e shpërqëndruar nga drejtimi i mjetit.

Instalimi i linjave 12V të lidhur direkt me baterine.

Cdo lidhje të ketë një siguresë të vecantë dhe të gjithë të kenë një siguresë kryesore.

Në murin e majtë të ketë të montuara priza elektrike 12V (furnizimi me energji elektrike për karikim monitordefibrilatori, aspiratori, figoriferi i medikamenteve dhe paisjeve që

kanë nevojë për karikim).

Ngarkese shtesë / inverter 12 / 220V 500hz. Konektor i drejtpërdrejtë 220V me 2 fole 220V (sipas SSH EN 1789 ose ekuivalent).

Impiant me dy bateri nga 70 A. Realizimi i një sistemi ushqyes me dy bateri. Bateria ndihmëse ushqen e vetme të gjithë ngarkesën elektrike të instaluar. Në rast defekti të baterisë kryesore, një paisje manuale lejon të lidhet bateria ndihmëse me motorrin e autoambulancës për ta ndezur. Në rast defekti të baterisë ndihmëse është e mjaftueshme ndezja e motorrit për të ushqyer të gjitha paisjet elektromedikale me energjinë e prodhuar nga dinamoja e mjetit. Sistemi shfrytëzon baterin e parë të mjetit, një bateri e dytë e mbyllur hermetikisht sipas normave e instaluar në gabinën e mjetit. Struktura dhe lidhjet të jenë të realizuara në mënyrë që të evitohet çdo mundësi të një lidhjeje të shkurtër.

Aspirimi dhe Ventilimi në tavanin e autoambulancës:

Ventilimi të jetë vendosur në tavanin e ambulances. Ky veprim aktivizohet me një buton në pjesën e emergjencës. Daljet e aspirimit dhe ventilimit të jenë të pavarura nga njëra tjetra.



Ngrohje e pavarur me ngrohës (turbinë) që prodhon ajër të ngrohtë me dalje nga posht-lart, në mënyrë të pavarur nga motori, në pjesën e pasme të autoambulancës (sipas SSH EN 1789 ose ekuivalent).

Ndriçimi për pjesën e emergjencës

Në tavan, të jenë vendosur 4 dritat të pavarura mbi barelën e cila lejon ndriçimin në të gjithë trupin e pacientit. Në të gjithë gjerësinë e automjetit të ketë ndriçim NEON. Dritat të jenë të pavarura nga pjesa e drejtimit në pjesën e emergjencës.



Sediljet

- Nje sedilje të jetë ngjitur me murin ndarës të gabinës në pjesën e pasme të mjetit, nga jashtë e veshur me material imitim lëkure, e pajisur me rrip sigurimi me tre pika fiksimi dhe me dy mbështetëse duarsh në 2 pjesët anësore.

Një sedilje të jetë në pjesën anësore djathtas, anash barrelës së pacientit, nga jashtë e veshur me material imitim lëkure, e pajisur me rrip sigurimi me tre pika fiksimi dhe me dy mbështetëse duarsh në 2 pjesët anësore.

Numri i përgjithshëm i ulëseve në dhomën e pacientit të jetë minimalisht 1+1.

Të plotesojne standartet SSH EN 1789:2007+A2:2014 ose ekuivalent,

Materiali rezistent ndaj detergjenteve te pastrimit dhe desinfektimit

Dritat

-Drita LED te vendosur në 2 grupe mbi çatinë e mjetit.

- Në parakolp të kete vendosur 2 drita me sinjal Blu.

- Paneli i kontrollit te gjendet në kabinë të shoferit.

- **Ndriçimi dhe Paneli i kontrollit në kabinën e pacientit të autoambulancës**

Të ketë një panel komandimi që shërben në pjesën e pasme të autoambulancës për kontrollin e impianteve dhe aparaturave të instaluara në bordin e mjetit. Funkcionet e parashikuara janë drita gjatë ditës ON/OFF, drita blu për natën ON/OFF. Buton ndezje për aspirim, ventilim dhe ajrim me rregullues.

Pamja e jashtme e autoambulancës:

Logot e autoambulancës të vendosura në mënyrë të dukshme dhe fluoreshente për shikimin gjatë natës.

Aksesorë të tjerë

- kosh i plehrave, pajimet në derën e pasme, cekic/ leve dhe pajisja për mbrojtje nga zjarri.

IV. SPECIFIKIME TEKNIKE TË PAJISJEVE DHE APARATURAVE MJEKËSORE TË KABINËS SË PACIENTIT.

GARANCIA : 2 vjet për paisjet dhe aparaturat mjekësore.

Ambulanca duhet të ketë këto paisje dhe aparatura mjekësore si më poshtë:

Sistemi për oksigjen

-2 cope bombula oksigjeni autoambulance statike të vendosura në pjesën e pasme të autoambulancës me volum 7 deri në 10 litra secila.

-Të kenë reduktor (manometër) të presionit me manometër. Të kenë fole për çdo bombël oksigjeni.

-Matës i rrjedhjes me një normë 0-15 l/min me një umidifikues (lagështues).

Pajisjet e sistemit të oksigjenit duhet të plotësojnë standartet SSH EN 1789:2007+A2:2014 ose ekuivalent, ISO 9001:2015 ose ekuivalent, CE ose ekuivalent dhe standartet për pajisjet e gazrave nën presion.

-Paisje dhe aparatura mjekësore për autoambulanca:

1-Barela lëvizëse me dyshek.



Të ketë barele me katër rrota me mundësi manovrimi për tu transportuar dhe ngarkuar në autoambulancë, me lartësi të ndryshme, me material polikromatik, e paisur me një strukturë dyshemeje, e përbërë prej polietileni me dendësi të lartë, me krahë me sistem hapje/mbyllje të shpejtë, me rrip sigurimi dhe sigures për shkurtim dhe zgjatim të tij, të integruar dhe me sistem fiksimit të çertifikuar 10G. Barele të palosëshme.

Përmasat e barelës të jenë gjatësia nga 1840 deri në 2000 dhe gjerësia nga 550 deri në 600 mm. Peshat e barelës jo më shumë se 45 kg dhe mund të mbajë peshë deri në 250 kg, gjithashtu të ketë frenat e pasme, të ketë 4 rrota të rrotullueshme të aktivizueshme me sistemin nga ana e këmbëve të pacientit. Të ketë sistem të ngritjes së pjesës së këmbëve (Trendelenburg). Të ketë dyshek për barelën sipas SSH EN 1865-1:2010+A1:2015 ose ekuivalent dhe CE 93/42 ose ekuivalent.

-Blokimi i barelës.

Sistem bllokimi anterior dhe posterior për barelën të testuar sipas "10G", në konformitet me kërkesat dhe normat teknike EN 1865 e EN1789.

Plani horizontal i barelës të ketë një suport me sistem spostimi anësor. Plani të jetë i përbërë me material alumini, lehtësisht i pastrueshëm. Sistemi i lëvizjes anësore të ketë bllokues dhe lirues në disa pika të këtij plani, rrëshqitës për të lehtësuar ngjitjen e barelës në autoambulance.

2. Set imobilizimi për frakturat e gjymtyrëve (splint tre masa)



- Përmasat e masës S
- Përmasat e masës M
- Përmasat e masës L
- Pompë alumini me vakum manual
- Xhepi i papërshkueshëm nga uji me hapësirë ruajtëse për vendosjen e pompës
- Të krijojë një dhomë të brendshme me vakum, që lejon shpërndarjen e parregullt të materialit të pjesës së brendshme, me saldime ultrasonik të gjerë.
- Përdorimin e materialit shumë rezistent, i cili gjithashtu është i lehtë për t'u pastruar dhe numri i madh e shiritave.
- Pozicioni i valvulave është i ndryshëm në të tre madhësitë në mënyrë që ato të mund të vendosen lehtësisht.

3. Bllokues i kollonës cervikale (qafore)



- Të jetë me përmasat jo më pak se 30x30 cm
- Të garantojë gjatë lëvizjes së të dëmtuarit një imobilizim sipas aksit anatomik të sigurt të vertebrave cervikale .
- Të sigurojë kontroll të lëvizjeve aksiale dhe përkuljeve laterale të kollonës.
- Të jetë e realizuar me material polietilieni me densitet të ulët, që siguron pastrim të lehtë.
- Të jetë fleksibël në aplikim, dhe me strukturë të ngurtë për imobilizim.
- Të ketë një hapje të përparme për të lehtësuar aksesin e trakeotomisë

4. Barrele (traume spinale) për shtyllen kurrizore dhe bllokues koke.



- Të jetë me përmasa jo më pak se 400 x 50 x 1800 mm dhe pesha të jetë nga 7 deri në 10 kg, kapaciteti mbajtës i peshës jo më pak se 150 kg.
- Të jetë e përshtatshme për adultët dhe fëmijët.
- Të jetë nga material i përshtatshëm që të lejojë pastrimin dhe dezinfektimin nga infeksionet.
- Të ketë material ngjitës (velkro "ose ekuivalent") për bllokuesin e kokës.
- Të ketë bllokues koke me ngjitës që vendoset dhe të jetë i montueshëm në barrelën spinale.



- Të jetë e përbërë nga material sfungjeri me densitet të lartë dhe nga jashtë e mbuluar me veshje hidrozistente.
- Të parandalojë çdo lëvizje të kokës së të dëmtuarit gjatë transportit.

5- Barrelë Luge

Barrelë në formë luge, e çmontueshme e kompletuar me rripat e sigurimit.

Barela në formë luge me dimensione si më poshtë:

Gjatësia jo më pak se 1500 mm deri në 2000 mm

Gjerësia: minimumi 400 mm

Gjatësia (e mbyllur): maksimumi 1300 mm

Pesha jo më shumë se 12 kg

Pesha mbajtja jo më pak se 150 kg.

Materiali i barelës në formë luge duhet të jetë e fortë , e lehtë me hapësira anësore për futjen e dorës dhe lidhjen e rripave të sigurisë.

Duhet të jetë me gjatësi të rregullueshme për ngarkimin e pacientëve me përmasa të ndryshme.

Duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë që të ndahet dhe bashkohet për përdorim sipas nevojës.

Forma duhet të jetë në konkave për të reduktuar në maksimum lëvizjet laterale.

Të ketë tre rripa sigurimi për mbrojtjen e pacientit dhe me hapje të shpejtë, me kapse femër-mashkull.




6. Sistem nxjerrje dhe imobilizimi spinal (KED, Kendrick Extrication Device)



- Të ketë përmasa jo më pak se 90 x 83 cm (gjat x gjer)
- Pesha jo më pak se 3 kg
- Të jetë e ngurtë në drejtim vertikal dhe fleksibilitet horizontalë
- Rripat dhe kaset të jenë të ngjyrosura për njohje të lehtë femër- mashkull.

7-Barrelë mushama:



- Me përmasa afërsisht 180x150 cm

- E përbere nga; najlon polipropileni , me ngarkesë thyerje deri ne 400 kg, per te rritur elasticitetin dhe shirita perforcues per kontrollin e ngarkeses deri ne 400 kg.
- E pajisur me qepje të dyfishta dhe me ngjitje për rritjen e sigurisë, të gjitha të bëra me fibra najloni të qëndrueshme dhe që nuk çahen.

8- Spider(Rrip sigurimi)



- Të mundësojë një fiksion të shpejtë të të dëmtuarit në barrelën spinale, duke garantuar parandalimin e dëmtimeve të strukturave anatomike,
- Të mundësojë një imobilizim korrekt të kolonës dhe artikulacioneve, edhe gjatë transporteve në kushtë të vështira.
- Rripat të jenë prej materiali rezistent, elastik dhe shumë të qëndrueshëm, të kenë në pjesën fundore të tyre ngjitëse (velkro “ose ekuivalent”) që mundësojnë fiksionin e sigurt në barrel të pacientit dhe njëkohësisht të mundësojnë shkëputjen e lehtë prej saj, në momentin e heqjes së spiderit (rripit të sigurisë).

9- Gërshërë



Të përbëra nga material celiku, mbështjellëse plastike, në pjesën e dorezave.

10. Pompe thithese portative (aspirator),volumi thithes min 1000 ml, 12 V dhe 220 V.

Pompe thithese portative të jetë me karikues baterie. Të jetë elektrike dhe me bateri, me peshë nga 2-3,5 kg. Motor me membranë sigurie për ndalimin e hyrjes së lëngjeve në motorin e aspiratorit. Të ketë depozitë për mbledhjen e sekrecioneve biologjike. Të ketë kabëll për ushqyes 220V dhe suport me qark karikimi.

11. Set diagnostikues i parametrave jetësor, i përbërë si më poshtë:

- Aparat tensioni portabël (sfigmomanometer), lehtësisht i lexueshem nga çdo kend. Manshetat e perfshira si për adult dhe pediatrik..
- Stetoskopi të përbëhet nga membranë që dedektojnë dhe amplifikojnë zhurmat kardiake dhe ato respiratore. Koka e përbërë prej inoksi që të dedektojë dhe tinguj me frekuenc të ulur.
- Termometri elektronik



Pajisja elektronike për matjen e temperaturës së trupit, i thjeshtë në përdorim dhe me precizion të lartë

- Pulsoksimetër për matjen e sasisë së oksigjenit në gjak.



-Glukometër dhe strishot për glukometër



Me sistem për matjen e sasisë së glukozës në gjak.

Të masë sasinë e glukozës në gjak, duke e nxjerrë atë nga shirita në të cilën është hedhur një pikë e gjakut kapilar, shiritat /strishot janë reactive në sajë të elektrodës me sensorë.

12. Monitordefibrilator per autoambulancat:

Të plotësojë karakteristikat si më poshtë:

- Të ketë selektor në tre pozicione
- Pozicion për defibrilim manual, dhe të sinkronizuar për goditje elektrike me piastra manuale.
- Pozicion AED (Automatic External Defibrillation), që do të thotë semiautomatik, që kryen defibrilim me piastra autoadezive.

- Pozicion monitorimi dhe regjistrimi të EKG (Elektrokardiograma).

Të ketë monitor me ngjyra TFT-LCD, rezistent kundrejt goditjeve dhe demtimeve, ku te pasqyrohen min 5 kanale **EKG**, pulsi, parametrat jetësor, alarmet etj.

Diapazoni i shkakimit te energjise 1-230 J

Koha e karikimit te monitor-defibrilatorit per goditje elektrike te jete jo me shume se 8 sekonda per 230 J

Minimumi i kohëzgjatjes se baterisë të jetë 2 orë

Impuls bifazik qe ndryshon sipas specifikave te pacientit ne Automatic Mode

Te identifikojë nese pacienti ka pacemaker te implantuar ose jo per sigurine e tij.

EKG 5 kanale

Printer termal te integruar per te printuar **EKG-ne 5 kanalshe**

Rrip mbajtës dhe xhepa anesore te integruar per ruajtje nga demtimet dhe transport te shpejte te aksesoreve

Memorje per ruajtjen e te dhenave minimum 3 GB

Elektroda pediatrike dhe adulte te integruara

Elektoda ngjitese per defibrilim automatic dhe pacemaker

Mbajtës dhe karikues baterie ne levizije,

13. Karroca/Karrige Transportuese pacienti



Karriget të karakterizohen nga konstruksion alumini,

Doreza të pasme të palosshme anti rrëshqitëse,

Doreza të përparme, të zgjatshme, me mekanizëm bllokimi dhe zhbllokimi.

Ndenjësjë e karigës të jetë me material PVC ose Najlon,

Mbështetësja e shpinës të jetë me material PVC ose PE, antirreshqitës,

Rrotat e pasme me diametër të madh, rrotat e përparëme të xhirueshme, të pozicionueshme me bllokues.

E pajisur me mbështetëse për vendosjen e këmbëve të pacienti, si dhe dy rripa për bllokimin e pacientit në karrige.

Karroca duhet të kete një kapacitet të paktën 160 kg.

Pesha e karrocës nuk duhet të kalojë 12 kg.

Sistemi i fiksimit në dyshemenë e autoambulancës.

14. Çanta e autoambulancës

Çanta e emergjencës për autoambulanca të ndihmës së parë të jetë multifunksionale, duhet të jetë me përmasa jo më pak se 60x20 cm

- Me qepje dhe me ngjitje
- Me ndarje të brëndshme, 5 çanta të vogla
- Të jetë me zinxhirë, që çmontohet në pjesë të ndryshme.
- Të ketë xhepa anësore me zinxhirë
- Komode në pjesën e shpinës, dhe me rripat me sfungjer
- Të jetë e përshtatshme për vendosjen e seteve të ndryshme (infuzioni, mjekimi, intubimi etj)
- Të jetë e përbërë nga material shumë rezistent me kapacitet të lartë mbajtës dhe me strisho fosforeshente.



(Foto ilustruese e cantave të vogla)

15-Frigorifer autoambulance për medikamente :

Të ketë frigorifer ftohës për autoambulanca për mbajtjen e medikamenteve që duhen ruajtur në temperature të ulta.

Volumi: 8 deri në -10 litra.

Tensioni: 12V/24Vdc. (230V ushqyes/trasformatore,

Të ketë: kavo ushqyese me spina karikimi makine, me doreze transporti.

- **GRAFIKU LËVRIMIT.**

2 deri 3 muaj nga lidhja e kontratës.

- **LOGO**

Automjetet duhet të kenë të vendosur logon e AAPSK (Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestrara dhe të Konfiskuara)

- **SHËRBIMET PROFILAKTIKE**

Duhet të përfshihen nga Operatori Ekonomik për 2 vite ose 150 000 km (në varësi të asaj që vjen e para)

Shërbimi profilaktik gjatë periudhës së garancisë prej 2 vite ose deri në 150 000 km duhet të jenë pjesë integrale e ofertës, sipas një grafiku shërbimi të miratuar (ndërrim filter vaji, karburanti, ajri, kabine, ferrotat të parme dhe të mbrapme).

Shërbimi i zhdoganimit, targimi i automjetit, sigurimi i automjetit me Kasko dhe TPL, të përfshihen në çmimin e automjetit.

SHENIM: Te gjitha fotot e pasqyruara në këtë material janë foto ilustruese dhe nuk i referohen asnjë prodhuesi dhe modeli konkret.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Shtojca 5.

Loti 5 “Blerje furgon mallrash për Drejtorinë Përgjithshme të Burgjeve”

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

KATEGORIA: FURGON PËR TRANSPORT MALLRASH 3.5 TON

| | |
|---|--|
| Viti i prodhimit të automjetit: | 2023-2024 |
| Modeli: | 2023-2024 |
| Statusi: | I ri me km zero ± lëvizjet e nevojshme për rregjistrim |
| Tipi i motorit: | Motor Naftë (Diezel) |
| Kapaciteti (cilindrata e motorit) në litra: | 1.95 deri 2.5 litra |
| Fuqia Motorrike: | 100 deri 180kË |
| Konsumi i kombinuar i karburantit: | Max: 9.5 litra /100km |
| Emetimi i gazrave: | Euro 6 – 6d |
| Sistemi i drejtimit: | Hidraulik |
| Numri i dyerve: | 4 (katër) |
| Kambio: | Manuale me 6 shpejtësi |
| Sistemi i drejtimit: | Me 4 rrota me nje aks aktiv (4 x 2) |
| Ngjyra: | E bardhe |

Përmasat e automjetit:

| | |
|-----------------------|---------------------|
| Gjatësia totale (mm): | min 5950 - max 6800 |
| Gjërësia totale (mm): | min 2300 - max 2500 |
| Lartësia totale (mm): | min 2300 - max 2800 |

Përmasat e zonës së ngarkesës:

| | |
|---------------------------------------|---------------------|
| Gjatësia e zonës së ngarkesës (mm) | min 3300 – max 4300 |
| Gjerësia e zonës së ngarkesës (mm) | min 1780 – max 1800 |
| Lartësia e zonës së ngarkesës (mm) | min 1800 – max 2100 |
| Volumi i karrocisës (m ³) | min 9.9 - max 15 |

Te dhenat e peshës:

| | |
|-----------------------------|---------------------|
| Pesha Totale e lejuar (kg) | 3500 |
| Pesha Bosh (kg) | min 1450 – max 2350 |
| Kapaciteti i ngarkesës (kg) | min 766 – max 1200 |

Sisteme elektronike të sigurisë:

ABS – sistemi kundër bllokues i rrotave gjatë frenimit,
ASR – sistemi kundër rrëshqitjes këndore të rrotave,
ESP – sistemi i stabilitetit elektronik,
